Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Azemine Maraj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Azemine Maraj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije Sutaj




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br.427 /2023	Data: Datum: 24.05.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-4351 të datës 31.01.2023, të parashtruar nga Ganimet Shatri nga fshati Tomoc, Komuna e Istogut, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-4351 e datës 31.01.2023, e parashtruar nga Ganimet Shatri, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozimin e Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **200.00 € (dyqind euro)**, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, kategoria ekonomike subvencione e transfere, si ndihmë momentale për shërim.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e djalit Labinot Shatri, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ganimet Shatri, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-4351, me datë 31.01.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi propozimin e komisionit për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Ganimetja është e sëmurë dhe ka nevojë për blerjen e terapisë për shërim, e cila është mjaftë e kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanke të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **200.00 € (dyqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Labinot Shatri, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ganimet Shatri,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije Sutaj



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br.426 /2023	Data: Datum: 24.05.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-1791 të datës 12.01.2023, të parashtruar nga Jeton Zekaj nga Istogu dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për shërimin e prindit Ahmet Zekaj, të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-1791 e datës 12.01.2023, e parashtruesit Jeton Zekaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e prindit Ahmet Zekaj dhe me propozimin e Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00 € (një qind e pesëdhjetë euro)**, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, kategoria ekonomike subvencione e transfere, si ndihmë momentale për shërim.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e djalit Jeton Zekaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Jeton Zekaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-1791, me datë 12.01.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi propozimin e komisionit për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Ahmeti është i sëmurë dhe ka nevojë për blerjen e terapisë për shërim, e cila është mjaftë e kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanke të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00 € (një qind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e djalit Jeton Zekaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Jeton Zekaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije Sutaj




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br.425 /2023	Data: Datum: 24.05.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-937 të datës 06.01.2023, të parashtruar nga Ramo Morinaj nga fshati Serbobran, Komuna e Istogut, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-937 e datës 06.01.2023, e parashtruesit Ramo Morinaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozimin e Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00 € (një qind e pesëdhjetë euro)**, nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, kategoria ekonomike subvencione e transfere, si ndihmë momentale për shërim.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Ramo Morinaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ramo Morinaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-937, me datë 06.01.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi propozimin e komisionit për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet së Ramo është i sëmurë dhe ka nevojë për blerjen e terapisë për shërim, e cila është mjaftë e kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanke të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Ramo Morinaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ramo Morinaj,
- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije Sutaj



Kryetari i Komunës
Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br.424 /2023	Data: Datum: 24.05.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-8826 të datës 02.03.2023, të parashtruar nga Musa Vuthaj nga fshati Vrellë, Komuna e Istogut, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-8826 e datës 02.03.2023, e parashtruesit Musa Vuthaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozimin e Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00 € (një qind e pesëdhjetë euro)**, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, kategoria ekonomike subvencione e transfere, si ndihmë momentale për shërim.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Musa Vuthaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Musa Vuthaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-8826, me datë 02.03.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi propozimin e komisionit për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet së Musa është i sëmurë dhe ka nevojë për blerjen e terapisë për shërim, e cila është mjaftë e kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanke të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Musa Vuthaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Musa Vuthaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije Sutaj




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br.423 /2023	Data: Datum: 24.05.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-8686 të datës 02.03.2023, të parashtruar nga Sanije Pacaj nga fshati Orroberdë, Komuna e Istogut, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-8686 e datës 02.03.2023, e parashtrueses Sanije Pacaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozimin e Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00 € (një qind e pesëdhjetë euro)**, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, kategoria ekonomike subvencione e transfere, si ndihmë momentale për shërim.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Sanije Pacaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Sanije Pacaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-8686, me datë 02.03.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi propozimin e komisionit për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet së Sanija është e sëmurë dhe ka nevojë për blerjen e terapisë për shërim, e cila është mjaftë e kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanke të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Sanije Pacaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Sanije Pacaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije Sutaj




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br.422 /2023	Data: Datum: 24.05.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-9227 të datës 03.03.2023, të parashtruar nga Hyle Pacaj nga fshati Orroberdë, Komuna e Istogut, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-9227 e datës 03.03.2023, e parashtrueses Hyle Pacaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozimin e Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, kategoria ekonomike subvencione e transfere, si ndihmë momentale për shërim.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Hyle Pacaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Hyle Pacaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-9227, me datë 03.03.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi propozimin e komisionit për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Hyla është e sëmurë dhe ka nevojë për blerjen e terapisë për shërim, e cila është mjaftë e kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanke të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Hyle Pacaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Hyle Pacaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije Sutaj




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-421/023	Data: Datum: 23.05.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nënin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 22.05.2023, të pranuar me datën 23.05.2023 për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Furnizimi me pelet për ngrohje në institucionet komunale”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-4622-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-034-136, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Furnizimi me pelet për ngrohje në institucionet komunale”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-4622-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-034-136 dhe në komision caktohen:

1.1 Brahim Hetemaj, Kryesues i Komisionit;

1.2. Florije Bytyçi, anëtare;

1.3. Shefqet Imeraj, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Furnizimi me pelet për ngrohje në institucionet komunale” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Prokurimi.

Vendimi i dërgohet:

-Komisionit,

-Prokurimit dhe

-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ





Kryetari i Komunës
Z.ILIR FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-419/023	Data: Datum: 19.05.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e prokurimit 15.05.2023 të pranuar me datën 17.05.2023 për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Furnizimi me table sportive me LED në palestër të qytetit”, nxjerr:

V E N D I M

1.CAKTOHET: Menaxhere e kontratës **znj, Arta Fetahu**, Udhëheqëse e Sektorit për Zhvillim, për projektin: “Furnizimi me table sportive me LED në palestër të qytetit” me numër prokurimit 633-23-2744-136/C712 dhe me numër të brendshëm 633-023-016-136, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: z. Genc Ademaj**, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori ekonomik **“LINDI MARKINGS” SH.P.K.**

2. Menaxherja e kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxheres së kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Përgjegjësin për realizimin e projekteve të lartcekur e merr: Menaxherja e kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Arta Fetahu, Menaxhere e kontratës,
- Genc Ademaj, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxheres së kontratës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës-ZKA
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-418/2023	Data: Datum: 19.05.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 19.05.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Trajtimi, Kastrimi dhe Sterelizimi i qenve endacak”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-435-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-027-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Trajtimi, Kastrimi dhe Sterelizimi i qenve endacak”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-435-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-027-2-2-1 dhe në komision caktohen

- 1.1. Muhamet Demaj,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2 Tahir Maksutaj,** anëtar;
- 1.3. Shefqet Imeraj,** anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Trajtimi, Kastrimi dhe Sterelizimi i qenve endacak”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br. 01-417/2023	Data: Datum: 19.05.2023	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 19.05.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Riparimi i rrugëve lokale të rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-2733-1-1-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-012-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Riparimi i rrugëve lokale të rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-2733-1-1-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-012-1-1-1 dhe në komision caktohen

- 1.1. Naser Nimanaj,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Albert Hasanaj,** anëtar;
- 1.3. Driton Alihajdaraj,** anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Riparimi i rrugëve lokale të rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.


7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ**



**Kryetari Komunës
z.Illir FERATI**



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-416/2023	Data: Datum: 19.05.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 19.05.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Shitja e masës drunore të zjarrit dhe teknik- Lot1 “Dru të konfiskuara-Sine”; Lot2 “Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Radusha ngastra NR.45/ në ngastra 061,062,069,070,071”; LOT3--“Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Lugu i Butë ngastra NR.45/ në ngastra 02,05; LOT4--“Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Lugu i Butë ngastra NR.46/ në ngastra 01,04,05,06, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-4134-1-6-10, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Shitja e masës drunore të zjarrit dhe teknik- Lot1 “Dru të konfiskuara-Sine”; Lot2 “Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Radusha ngastra NR.45/ në ngastra 061,062,069,070,071”; LOT3--“Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Lugu i Butë ngastra NR.45/ në ngastra 02,05; LOT4--“Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Lugu i Butë ngastra NR.46/ në ngastra 01,04,05,06, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-4134-1-6-10 dhe në komision caktohen

1.1. Fadil Kabashi, Kryesues i Komisionit;

1.2 Xhevat Idrizaj, anëtar;

1.3. Driton Alihajdaraj, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektet: Shitja e masës drunore të zjarrit dhe teknik- Lot1 “Dru të konfiskuara-Sine”; Lot2 “Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Radusha ngastra NR.45/ në ngastra 061,062,069,070,071”; LOT3--“Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Lugu i Butë ngastra NR.45/ në ngastra 02,05; LOT4--“Shitja e masës drunore në njësinë menaxhuese Lugu i Butë ngastra NR.46/ në ngastra 01,04,05,06, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t'iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi .

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

-Komisionit,

-Prokurimit,

-Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe

-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

[Signature]

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-413/2023	Data: Datum: 18.05.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62 i miratuar me datën 30.11.2010, dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Mirëqenie Sociale shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-14658 të datës 13.04.2023, të parashtruar nga Liridona Rexhaj nga fsh. Tomoc, përfaqësuese e familjes strehuese e cila strehon fëmijët e braktisur, për përkrahje me mjete financiare dhe me shkresë 06Nr.122/2023 të datës 26.04.2023 i propozon Kryetarit, të nxjerr:

V E N D I M

1.MIRATOHEN: kërkesat Nr.06-553-14658 e datës 13.04.2023 e parashtruar nga Liridona Rexhaj, dhe Raporti i Qendrës për Punë Sociale i datës 20.04.2023, propozojnë që familja e cekur me lartë të përkrahet me mjete financiare në shumë prej 500.00€ (pesëqind euro).

2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet në xhirollogarinë e Liridona Rexhaj nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

4. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Liridona Rexhaj,
- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br. 01-412/023	Data: Datum: 18.05.2023	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 08.05.2023, për themelim të komisionit për aprovim të strukturave sipas Ligjit Rr.08/L-183 për Mbështetjen e Punëve Publike për projektet e komunës së Istogut, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për aprovim e strukturave sipas Ligjit Rr.08/L-183 për Mbështetjen e Punëve Publike për projektet e komunës së Istogut dhe në komision caktohen:

- 1.1. Gëzim Ademaj,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Albert Hasanaj,** anëtar;
- 1.3. Arta Fetahu,** anëtare.

2. Komisioni do të bëjë aprovim e strukturave sipas Ligjit Rr.08/L-183 për Mbështetjen e Punëve Publike për projektet e komunës; kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe vlerësimin e strukturave për shkak të inflacionit; do të hartoj raportin si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për aprovim të strukturave për projektet e komunës e merr Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Prokurimi.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimi,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ**



**Kryetari Komunës
Zllir FERATI**



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-409/2023	Data: Datum: 18.05.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, bazuar në nenin 19 të Ligjit për Gjuetinë Nr. 02/L-53 dhe bazuar në Udhëzimin e Administrativ MA Nr. 10/2007 kriteret e caktimit të zonave dhe procedurat e themelimit të vendgjuetive, shqyrtoj kërkesën 09Nr.64/2023 të datës 10.05.2023 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, për themelimin e Komisionit për përgatitjen-përshkrimin për themelimin e vendgjuetisë në Komunën Istogut, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për përgatitjen-përshkrimin për themelimin vendgjuetisë në Komunën Istogut dhe në komision caktohen:

- 1.1. Daut Kabashi,** Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Xhevat Idrizaj,** anëtar;
- 1.3. Valbona Kaliqanaj,** anëtare;
- 1.4. Bajram Sejdiqaj,** anëtar; dhe
- 1.5. Meriton Ahmetaj,** anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë ka për obligim që të bëjë përgatitjen-përshkrimin për themelimin vendgjuetisë sipas Udhëzimin e Administrativ MA Nr.10/2007 kriteret e caktimit të zonave dhe procedurat e themelimit të vendgjuetive; do të njoftoj Kryetarin me përshkrimin për themelimin vendgjuetisë si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-408/023	Data Datum: 18.05.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 06Nr.125/2023 të datës 11.05.2023 të parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndërrimin e Kryesuesit të Komisionit sipas pikës 1.1 të Vendimit 01 Nr.380/2022 të datës 06.06.2022 për verifikimin e gjendjes së rasteve të strehimit social dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1.MIRATOHET: kërkesa 06Nr.125/2023 e datës 11.05.2023 e parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndërrimin e Kryesuesit të komisionit sipas pikës 1.1 të Vendimit 01 Nr.380/2022 të datës 06.06.2022 për verifikimin e gjendjes së rasteve të strehimit social, pasi që Kryesuesi i Komisionit **Abedin Neziraj** është emëruar Këshilltar politik i Ministrit të Ministrisë Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në vend të tij caktohet **Jozef Frrokaj**, Kryesues i Komisionit, për dalje në vendngjarje për verifikimin e gjendjes së rasteve të strehimit social :

2. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Jozef Frrokaj dhe Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

3. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Jozef Frrokaj,
- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-406/2023	Data: Datum: 18.05.2023	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68, 68.1 paragrafi 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoj kërkesën 04Nr.553-15640 të datës 24.04.2023 të parashtruar nga Shefqet Shoshi nga fsh. Istog i Poshtëm për kompensimin e demit të shkaktuar nga komuna në pronën e tij si dhe shqyrtoi Raportin e Komisionit të datës 17.05.2023 për vlerësimin e demit të shkaktuar në pronën e Shefqet Shoshit, Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 04Nr.553-15640 e datës 24.04.2023 e parashtruar nga Shefqet Shoshi për kompensimin e demit të shkaktuar nga komuna në pronën e tij si dhe Raportin e Komisionit të datës 17.05.2023 për vlerësimin e demit në pronën e Shefqet Shoshit, për demin e shkaktuar gjatë realizimit të punimeve të ujësjellësit për projektin: "Ndërtimi i skemës me furnizim me ujë në Komunën e Istogut (pjesa lindore)", i ndahen **800.00€(tetëqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Shefqet Shoshit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Shefqet Shoshi, ka parashtruar kërkesën Nr.04-553-15640 të datës 24.04.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e demit të shkaktuar gjatë realizimit të punimeve të ujësjellësit për projektin: "Ndërtimi i skemës me furnizim me ujë në Komunën e Istogut (pjesa lindore).

Komisioni ka dalë në vend ngjarje dhe për se afërmi ka vlerësuar demin e shkaktuar dhe me Raportin e datë 17.05.2023 ka vlerësuar demin e shkaktuar gjatë realizimit të punimeve për projektin e lartë cekur dhe i propozon Kryetarit të përkrahet me mjete financiare në shumë prej me **800.00€ (tetëqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.


Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Shefqet Shoshi,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-405/023	Data: Datum: 18.05.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, në nenin 1 paragrafi 1 nenparagrafi 1.5 të Rregulloresë 01Nr.42/2014 për Ndarjen e Subvencioneve e miratuar me datë 30.06.2014, shqyrtoj kërkesën 02Nr.79/23 të datës 10.05.2023 të parashtruar nga Drejtori të Drejtorisë për Administratë Komunale, për përkrahje financiare të Liridona Rexhaj dhe Arlinda Rexhaj nga Komuna e Istogut, përfaqësuese të dy familje strehuese të cilat strehojnë fëmijët e braktisur, me rastin e shënimit të 15 Majit "Dita Ndërkombëtare e Familjes", nxjerr:

V E N D I M

